**BASHKIA MALIQ**
**DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE DHE PROKURIMET PUBLIKE**

**Nr________Prot** **Maliq, më 26.07.2024**

PROJEKT VENDIM - NR. 7

**<u>Për dhënien në përdorim të përkohshëm të fondit pyjor në pronësi dhe administrim të Bashkisë Maliq për ndërtim linjë elektrike Lenie-Maliq nga kompania Grabova 2.</u>**

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore*"i ndryshuar, neni 8, 9, pika 1, neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak, neni 55 "votimi", neni 64 "Kopetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë"; Ligj nr. 115/2014 datë 31.7.2014 "*Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*"; Ligj nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "*Për pyjet*" neni 23; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*", i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559 date 29.07.2022 "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor*"; Udhëzimi nr. 1, date 09.06.2016 i Ministrit të Mjedisit "*Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*"; Raportit tekniko-ekonomik të Drejtoris së Pyjeve dhe Kullotave, Kontratës konçensionare e formës BOT nr.2026 Rep, nr.926/3 Kol,; Marrëveshjes për lidhjen me rrjetin e transmetimit linja Lenie-Maliq, të Hec Grabova 2 midis OST Sh.a. dhe subjektit Grabova 2 me nr. 2086/2 prot datë 19.04.2024; Kërkesës së subjektit Grabova 2 me nr. 2283 prot datë 30.04.2024 "Për marrjen në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor për ndërtimin e linjës së transmetimit Lenie-Maliq; dhe Raportit Tekniko-Ekonomik të Hartuar nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave.

I propozojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë kërkesën e dhënies në përdorim të përkohshëm të fondit pyjor në pronësi dhe administrim të Bashkisë Maliq për ndërtimin e linjës së tensionit të lartë 110 kV me një gjatësi prej 14.675km linjë elektrike dhe 16.62km rrugë ndihmëse.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve Publike, dhe Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, për vazhdimin e procedurave përkatëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar .

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0842 2026

**BASHKIA MALIQ**
**DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE DHE PROKURIMET PUBLIKE**

**Nr_________Prot** **Maliq, më 26 .07.2024**

**RELACION**

**<u>Për dhënien në përdorim të përkohshëm të fondit pyjor në pronësi dhe administrim të Bashkisë Maliq për ndërtim linjë elektrike Lenie-Maliq nga kompania Grabova 2.</u>**

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar, neni 8, 9, pika 1, neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak, neni 55 "votimi", neni 64 "Kopetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë"; Ligj nr. 115/2014 datë 31.7.2014 "*Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*"; Ligj nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "*Për pyjet*" neni 23; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*", i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559 date 29.07.2022 "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor*"; Udhëzimi nr. 1, date 09.06.2016 i Ministrit të Mjedisit "*Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*"; Raportit tekniko-ekonomik të Drejtoris së Pyjeve dhe Kullotave, Kontratës konçensionare e formës BOT nr.2026 Rep, nr.926/3 Kol,; **Marrëveshjes për lidhjen me rrjetin e transmetimit linja Lenie-Maliq, të Hec Grabova 2 midis OST Sh.a. dhe subjektit Grabova 2 me nr. 2086/2 prot datë 19.04.2024**; Kërkesës së subjektit Grabova 2 me nr. 2283 prot datë 30.04.2024 "Për marrjen në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor për ndërtimin e linjës së transmetimit Lenie-Maliq; dhe Raportit Tekniko-Ekonomik të Hartuar nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave.

**1. Dokumentacioni i dorëzuar dhe procedura e ndjekur.**

Hec Grabova 2 ka lidhur kontratë konçensionare të formës BOT për ndërtimin e hidrocentralit "Grabova 2" në Bashkinë Gramsh më datë 14 shtator 2017, dhe ka bërë dy shtesa kontrate koncensioni datë 22.06.2018 dhe 16.07.2021.

Është paisur me VNM Paraprake më datë 16.03.2021.

Më datë 11.10.2019 është miratuar projekti i zbatimit nga Ministria e infrastrukturës dhe energjisë

Subjekti Grabova 2 është pajisur me leje për ndërtimin e hidrocentralit në Lenie të Bashkisë Gramsh me nr. 1036/13 datë 24.10.2022.

***Më datë 19.04.2024 subjekti Grabova 2 ka nënshkruar marrë veshje me Operatorin e Sistemit të Transmetimit OST Sh.a për lidhjen me rrjetin e transmetimit të "Hec Grabova 2" dhe ndërtimin e linjës Lenie-Maliq 110 kV, dhe pas përfundimit të ndërtimit do të kryhet kalimi i pronësisë nëpërmjet dhurimit të linjës dhe nënstacionit Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST Sh.a).***

**Informacion rreth vendndodhjes së linjës elektrike që do ndërtohet nga shoqëria Grabova 2 :**

* Bashkëngjitur relacionit është harta treguese e gjurmës ku do të kaloj linja elektrike

2. **Relacioni teknik.**

Me marrjen e kësaj kërkese, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave në Bashkinë Maliq ka kryer vlerësimin e saj si më poshtë:

- Vendndodhjet e kërkuara ndodhen në ngastra pyjore në pronësi të Bashkisë Maliq, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 433 datë 8.6.2016 *"Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike..."*, i ndryshuar, dhe planeve të menaxhimit 2022;
- Kërkesa është në përputhje me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016 i Ministrit të Mjedisit *"Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"*, nëpërmjet të cilit kërkuesi legjitimohet për paraqitjen e kësaj kërkese;
- Kërkesa është në përputhje me procedurat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559 date 29.07.2022 *"Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor"*, Shtojca 1, Pika 13, në të cilën përcaktohen tarifat e dhënies në përdorim të fondit pyjor publik për linjë të tensionit të lartë.
- Është hartuar relacioni teknik nga Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, bazuar në procedurat e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559 date 29.07.2022 *"Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor"*. Vlera e përdorimit të fondit pyjor në shumën **1 463 500 lekë** do të derdhet për llogari të Bashkisë Maliq nga Subjekti Grabova 2 në momentin e lidhjes së kontratës së qirasë.

**Pas diskutimit nga anëtarët prezentë propozojmë të merren vendimet:**

1. Këshilli i Bashkisë Maliq të miratojë kërkesën e dhënies në përdorim të përkohshëm të fondit pyjor në pronësi dhe administrim të Bashkisë Maliq për ndërtimin e linjës së tensionit të lartë Lenie-Maliq nga subjekti Grabova 2 të një gjatësie linje elektrike prej 14.675km dhe 16.62km rrugë lidhëse.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861-2-2026


RRUGËT NË PYLLEZAIM
LINJA NË PYLLEZAIM
RRUGËT NDIHMËSE
LINJA E TENSIONIT
SHTYLLAT E TENSIONIT
EKONOMIA PYJORE
MOGLICË
HEC GRABOVA 2
2024
Coordinate System: WGS 1984 UTM Zone 34N
LEGJENDA
N


EKONOMIA PYJORE
STRELCË
2024
LEGJENDA
SHTYLLAT E TENSIONIT
LINJA E TENSIONIT
RRUGËT NDIHMËSE


RRUGET NDIHMESE
LINJA E TENSIONIT
SHTYLLAT E TENSIONIT
Lozhan
Zvarishte
Tresove
Qencke
Floviste
EKONOMIA PYJORE
MALIQ-LOZHAN
HEC GRABOVA 2
NGASTRAT E FONDIT PYJOR/ KULLOSOR QE PREKEN NGA NDERTIMI I LINJES ELEKTRIKE
2024
Coordinate System: WGS 1984 UTM Zone 34N
LEGJENDA
Shtylla
Linja e Tensionit
Kufit_e_Ekonomive
EP_Maliq_Lozhan
Kufi_Bashkie
N


EKONOMIA PYJORE
PIRG-MOCAN
2024
LEGJENDA
RRUGËT NDIHMËSE
LINJA E TENSIONIT
SHTYLLAT E TENSIONIT
N